



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 58 , Datë 02.04.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 303, DATË 23.10.2023,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“TEKSOEN 1”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 709/2 prot., datë 25.03.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 303, datë 23.10.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “TEKSOEN 1”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 303, datë 23.10.2023 ka vendosur të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30 vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 26.10.2024.
- Në kuadër të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 2 të vendimit të bordit, ERE me shkresën nr. 709 prot., datë 23.02.2024, i kërkoi shoqërisë informacion në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, pasi shoqëria nuk kishte informuar sipas afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit nr. 303/2023, me shkresën e depozituar në ERE nr. 709/1 prot., datë 04.03.2024 shoqëria na informoi se ka nisur punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik.

- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit nr. 303, datë 23.10.2023, i cili vlerësohet që të shfuqizohet. Me shfuqizimin e pikës 2, nuk gjen vend as pika 3 si e tillë shfuqizohet dhe pika 3 e këtij vendimi.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 dhe 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 303/2023, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI